REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**SEKTORI I PROJEKTEVE ME BE DHE MARREDHËNIEVE ME DIASPORËN**

**Nr._____Prot .** **Bilisht, më / /2025**

**PROJEKT-VENDIM**
**NR 86 /DATË 22/ 12 /2025**

**"PËR MIRATIMIN E MEMORANDIUMIT TË MIRËKUPTIMIT DHE BASHKËPUNIMIT DHE STATUTIT "**

Mbështetur në nenin 9, pika 1.5 b) e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar.

**PROPOZOJ:**

1.Të miratojë Memorandiumin e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit të nënshkruar nga Kryetarët e Bashkisë Devoll,Bashkisë Prespë,Bashkisë Resen dhe Bashkisë Pustec me objektiv në kontributin nëpërmjet aktiviteteve në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së Prespës.

2.Të miratojë Statutin me emrin EGTC "Grupi Evropian për Bashkëpunim Territorial I Prespës" I përbërë nga Bashkitë Devoll, Pustec (Shqipëri), Bashkitë Prespë (Greqi) dhe Bashkitë Resen (Maqedonia e Veriut).

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Projekteve me BE dhe Marëdhënieve me Diasporën.

4. Ky vendim do të hyje ne fuqi sipas percaktimeve te nenit 55 pika 6 te ligjit nr 139-2015 date 17.12.2025 "Per vetëqeverisjen vendore "I ndryshuar.

**Konceptoi:**

Përgjegjësi I Sektorit të Projekteve me BE dhe Marëdhënieve me Diasporën

**Remzi Kutrolli**

**Konfirmoi bazën ligjore**:

Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela Avdo

**Konfirmoi:**

Sekretari i Përgjithshëm

Adriana Rushitaj

**KRYETARI I BASHKISË**
**EDUARD DURO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**SEKTORI I PROJEKTEVE DHE INTEGRIMIT NE BE**

**Nr.** 4318 **Prot** **Bilisht, më** 22/9/**2025**

**Lenda: Relacion**

**"PER MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TE MIREKUPTIMIT DHE BASHKEPUNIMIT DHE STATUTIT TE EGTC PRESPA"**

**Drejtuar: Keshillit te Bashkise Devoll.**

## 1- Baza Ligjore

Bazuar ne Ligjin Nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", Pika 1. "Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:", Nen-pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës:", shkronja *b*) "**bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera** dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi"

## 2- Qellimi

Bashkite nderkufitare te zones se Prespes kërkojnë të forcojnë më tej përpjëkjet tona kolektive drejt zhvillimit të qëndrueshëm , ruajtjes se mjedisit dhe ruajtjes së kulturës brenda pellgut të Prespës përmes krijimit të nje Grupi Evropian të Bashkëpunimit Territorial (EGTC).

## 3- Funksionimi i EGTC Prespa

Grupi Evropian për Bashkëpunim Territorial i Prespës ka formatin ligjor te nje organizate jo fitimprurese sipas percaktimeve te ligjeve te BE-se. Ne dallim nga OJF-te e tjera te cilat jane ne rolin e partnerit ose perfituesit por gjithmone pjese e partneriteteve, Bashkimi Evropian permes programeve te tij, financon projekte te ndryshme me perfitues dhe vetem EGTC-te. Meqenese nje nga anetaret e EGTC eshte Bashkia Prespe ne Greqi, nje bashki e nje vendi anetar te BE-se e cila perfiton cdo vit mbi 12mln Euro grante nga programe te ndryshme te BE-se, ne si vend jo anetar, **rrisim mundesite per te perfituar fonde investimesh te ndryshme nga BE-ja duke qene pjese e nje grupi te perbashket.**

**Nga ana tjeter, Bashkia e Devollit do jete perfituese e investimeve pa marre barren e bashkefinancimit apo te pergjegjesise ligjore dhe teknike per zbatimin e projekteve.** Pavaresisht se shuma e bashkefinancimit te projekteve eshte ne masen 15%, koheshtrirja, proceset e auditimit dhe subvencionimit te projekteve sjellin vonesa dhe ngarkojne Bashkine Devoll me detyrimin per te likuiduar projektin ne masen 100% perpara perfundimit te afatit. Bashkia e Devollit ende nuk ka kapacitetet financiare per te financuar projekte investimesh me

vlere 300.000 – 350.000 EUR dhe per kete arsye ne projektin e fundit nZECom kemi kerkuar asistencen financiare te SASPAC.

Meqenese Bashkia Devoll ne 12 vitet e fundit ka qene perfituese e vetem 3 projekteve me financim nga programet IPA CBC, dy nga programi Maqedoni-Shqiperi dhe nje nga programi Greqi-Shqiperi, eshte pare e nevojshme grupimi me Bashki te tjera me eksperience me te madhe ne fushen e projekteve.

Bashkia Devoll ka qene partnere me Bashkine Prespe dhe Bashkine Resnje ne projektet fituese dhe Bashkia Prespe eshte fituese e nje projekti ne zbatim ne territorin e Bashkise Devoll por partner eshte Drejtoria Rajonale e Ujesjelles Kanalizimeve Korce.

Aktivitetet dhe menyra e funksionimit te EGTC Prespa eshte percaktuar te statuti bashkengjitur kesaj shkrese.

**PERGJEGJES I SEKTORIT TE PROJEKTEVE DHE INTEGRIMIT NE BE**
**Remzi Kutrolli**